



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 qershor 2012
Nr. ref.: RK250/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI46/10

Parashtruesi

**Sebahate Shala, në emër të Këshillit Organizativ
“Drejtësi për rastin Kiqina”**

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit P. nr. 162/03, të 7 prillit 2005, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; Aktgjykimit P.nr.628/04, të 8 marsit 2007, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 393/2006, të 21 majit 2008; Aktgjykimit API. Nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009, të Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ap. nr. 84/09, të 3 dhjetorit 2009

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Sebahate Shala nga Krajkova e Glogovcit, e cila e parashtron kërkesën në bazë të autorizimit të Këshillit Organizativ “Drejtësi për rastin Kiqina”. Parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) një peticion me nënshkrimet e afërsisht pesëdhjetë mijë (50.000) qytetarëve të Republikës së Kosovës në mbështetje të kërkesës së saj në Gjykatë.

2. Këshilli Organizativ “Drejtësi për rastin Kiqina” përbëhet nga studentë të Universitetit të Prishtinës, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Luftëtarëve të UÇK-së, aktivistë nga shoqëria civile dhe të tjerë.
3. Në kërkesë thuhet se parashtruesja e kërkesës përfaqësohet nga Visar Zogaj, student nga Malisheva. Sidoqoftë, formularin e kërkesës e ka nënshkruar ajo vetë.

Vendimet e kontestuara

4. Parashtruesja e kërkesës konteston Aktgjykimin P. nr. 162/03, të 7 prillit 2005, të Gjykatës së Qarkut në Gjilan; Aktgjykimin P. nr. 628/04, të 8 marsit 2007, të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë; Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 393/2006, të 21 majit 2008; Aktgjykimin API. Nr. 04/2009, të 16 shtatorit 2009, të Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. nr. 84/09, të 3 dhjetorit 2009.

Objekti i çështjes

5. Objekti i çështjes, sipas parashtrueses së kërkesës, është dënimi i padrejtë i pretenduar i Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës për vepra të rënda penale, përfshirë vrasjen. Parashtruesja e kërkesës pohon se ajo e përfaqëson një organizatë e cila pretendon se dënimi për vrasje dhe vepra tjera të rënda ndaj disa personave të caktuar në “rastet Kiqina”, përbënte shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 16 dhjetorit 2008 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56(2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 25 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 29 qershor 2010, Arben Kiqina parashtrroi një kërkesë në Gjykatë që është regjistruar të njëjtën datë me numër nr. KI 52/10.
9. Më 29 mars 2011, Jeton Sefer Kiqina parashtrroi një kërkesë në Gjykatë që është regjistruar në Gjykatë në të njëjtën datë me nr. KI 43/11.
10. Më 7 qershor 2011, Burim Ramadani, Arsim Ramadani, Arben Kiqina dhe Blerim Kiqina dorëzuan në Gjykatë një kërkesë me nr. KI 78/11.
11. Më 13qershor 2011, Burim Ramadani dhe Arsim Ramadani dorëzuan në Gjykatë një kërkesë të regjistruar me nr. KI 81/11.
12. Më 11 nëntor 2010, Kryetari e emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese në kërkesën KI46/10. Të njëjtën ditë, Kryetari e emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
13. Më 19 korrik 2011, Kryetari, me Urdhër BK-46/10, i bashkoi të gjitha këto kërkesa të ndara KI46/10, KI52/10, KI43/11, KI78/11 dhe KI81/11, për shkak të lidhshmërisë në mes tyre për nga objekti i çështjes dhe sa i përket personave që kanë bërë kërkesat.

Gjyqtari raportues dhe Kolegji shqyrtues mbeten po të njëjtit që u emëruan për këtë kërkesë.

14. Më 14 maj 2012, për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarit Ivan Čukalović, Kryetari caktoi veten, Enver Hasani, si gjyqtar zëvendësues në Kolegjin shqyrtues.
15. Më 15 maj 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi Raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në bazë të dokumenteve të parashtrueses së kërkesës të parashtruara në Gjykatë

16. Nga kërkesa dhe dokumentet e dorëzuara me të, përmbledhja e shkurtër e fakteve mund të konstatohet si në vijim.
17. Në mbrëmjen e 20 gushtit 2001, H. H., së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët ishin në një dasmë në fshatin Baicë. Pasi u larguan nga dasma, më vonë gjatë asaj nate, vetura e tij u sulmua nga pusia, ku ai, bashkëshortja e tij, djali dhe dy vajzat e tij u qëlluan për vdekje. Vetëm një vajzë e re shpëtoi.
18. Më 4 korrik 2002, Blerim Kiqina u mor në pyetje si dëshmitar nga Policia e Kosovës dhe ajo ndërkombëtare, me ç'rast ai dha deklaratë inkriminuese ndaj vetes dhe të tjerëve që pretendohet të ishin përfshirë në vrasje. Deklarata inkriminuese e Blerim Kiqinës ishte incizuar me kamerë.
19. Më 7 korrik 2002, Blerim Kiqina e përsëriti deklaratën inkriminuese të cilën e kishte dhënë më 4 korrik 2002 para Gjyqtarit hetues.
20. Procedura hetimore çoi deri te aktakuza dhe gjykimi i Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës, Jeton Kiqinës dhe të tjerëve.
21. Më 7 prill 2005, Gjykata e Qarkut në Gjilan me Aktgjykimin P. nr. 162/03, i shpalli Burim Ramadanin, Arsim Ramadanin, Arben Kiqinën dhe disa persona të tjerë të akuzuar fajtor për vrasje, vrasje në tentativë dhe bashkëpunim në kryerje të veprës penale të vrasjes së H. H. dhe familjes së tij. Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina të gjithë u dënuan veç e veç me burgim prej 30 vitesh. Disa nga akuzat u hodhën poshtë në atë proces gjyqësor.
22. Të akuzuarit u ankuan ndaj këtij dënimi dhe më 20 maj 2008, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin e saj Ap. nr. 393/2006, e hodhi poshtë ankesën e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit dhe Arben Kiqinës si të pabazuar dhe e vërtetoi dënimin e shpallur nga Gjykata e Qarkut në Gjilan, ndërsa të akuzuarit e tjerë Gjykata Supreme i liroi nga akuza sepse nuk mund të vërtetohet se i kishin kryer veprat penale për të cilat ngarkoheshin.
23. Më 16 shtator 2009, Kolegji i Veçantë Penal i Gjykatës Supreme me anë të Aktgjykimit API. Nr. 04/2009, hodhi poshtë një ankesë tjetër të ushtruar nga Burim Ramadani, Arsim Ramadani dhe Arben Kiqina ndaj aktgjykimit të lartpërmendur të Gjykatës Supreme si të pabazuar.

Përmbledhja e fakteve në lidhje me Jeton Kiqinën në bazë të dokumenteve të parashtrueses së kërkesës të parashtruara në Gjykatë

24. Më 8 mars 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me anë të Aktgjykimit P.nr.628/04, e shpalli Jeton Kiqinën fajtor për disa pika të aktakuzës përfshirë vrasjen, vrasjen në tentativë dhe bashkëpunim në kryerje të veprës penale të vrasjes së H. H. dhe familjes së tij të ngushtë. Jeton Kiqina u dënua me 15 vjet burgim.
25. Më 3 dhjetor 2009, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Ap. nr. 84/09, pjesërisht e miratoi ankesën e të akuzuarit Jeton Kiqina ku gjeti se ai ishte fajtor për pikat e aktakuzës vrasje dhe vrasje në tentativë, por e shfajësoi për pikën bashkëpunim në kryerje të veprës penale të vrasjes së H. H. dhe familjes së tij të ngushtë.

Kërkesa e parashtrueses dhe pretendimet e saj

26. Parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që:
 - a) Të shqyrtojë, analizojë dhe rivlerësojë shkeljen e të drejtave të njeriut ndaj personave të dënuar;
 - b) Të japë një mendim dhe të bëjë interpretimin e shkeljes së drejtave të njeriut që rezultoi nga këto dënime;
 - c) Të japë një mendim për shkeljen e të drejtave të njeriut të personave të dënuar; dhe
 - d) Të marrë vendim në bazë të kompetencave të Gjykatës nëse konkludon se janë provuar shkeljet e bëra ndaj personave të dënuar.
27. Parashtruesja e kërkesës pohon se janë shkelur këto nene të Kushtetutës: neni 21 [Të drejtat dhe liritë themelore], neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe mekanizmave ndërkombëtare], neni 29 [E drejta e lirisë dhe sigurisë], neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm] dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: Konventa).
28. Parashtruesja e kërkesës pretendon se asnjëra nga tri shkallët e gjyimit nuk e ka vërtetuar në mënyrë ligjore fajësinë e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës.
29. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në aktgjykimin e fundit të nxjerrë në vitin 2009, Kolegji i Veçantë Penal i Gjykatës Supreme nuk i miratoi ankesat e mbrojtjes. Kolegji i Veçantë Penal nxori aktgjykim me të cilën e vërtetoi dënimin por jo edhe akuzat. Parashtruesja e kërkesës pretendon se aktgjykimi në fjalë ishte në kundërshtim me dy shkallët më të ulëta të gjyimit dhe se arsyetimi i Kolegjit të Veçantë Penal të Gjykatës Supreme ishte në kundërshtim me vetveten.
30. Parashtruesja e kërkesës pretendon se i bashkakuzuari kryesor, Skënder Halilaj, së bashku me Florim Kiqinën dhe Zeqir Kiqinën u liruan më 12 korrik 2008, personat në fjalë ishin të akuzuar për të njëjtën veprë: planifikim, organizim dhe pjesëmarrje në vrasjen e H. H. dhe familjes së tij.
31. Parashtruesja e kërkesës pretendon se provat materiale dhe rezultatet e provave të ekzaminuara që e provonin pafajësinë e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës, ishin humbur dhe kurrë nuk u gjetën.

32. Parashtruesja e kërkesës pretendon se akuzat ndaj Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës ishin fabrikuar dhe në tërësi të përgatitura paraprakisht nga ana e Ekipit ndërkombëtar hetues të UNMIK-ut.
33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Jeton Kiqina u dënua me 16 vjet burgim nën akuzën se ka furnizuar me armë Florim Kiqinën, i cili më vonë pretendohet të ketë marrë pjesë në vrasjen e H. H. Mirëpo, Florim Kiqina u shpall i pafajshëm nga Gjykata Supreme e Kosovës në korrik të vitit 2008, ndërsa “furnizuesi” me armë, Jeton Kiqina, është ende burg. Gjykata e Qarkut në Gjilan e dënoi F. K. me 21 vjet burgim, nën akuzën e planifikimit, organizimit dhe pjesëmarrjes në vrasjen e H. H. dhe familjes së tij.
34. Parashtruesja e kërkesës pretendon se në kohën kur kishte ndodhur vrasja e H. H., më 20 gusht 2001, në ora 23:17, sipas regjistrimit të KFOR-it, ky grup i djelmohave po festonte ditëlindjen Burim Ramadanit në një kafiteri në Glllogoc. Aty ishin të pranishëm edhe tre policë, të cilët dëgjuan në radio lidhje lajmin e vrasjes së tmerrshme që kishte ndodhur në fshatin Tërstenik në Glllogoc. Këtë lajm pretendohet ta kenë dëgjuar të gjithë ata që po festonin.
35. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës iu mohua e drejta për gjykim të drejtë në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës.
36. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata të japë një mendim dhe interpretim në lidhje me shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe padrejtësinë që u është shkaktuar Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

37. Në mënyrë që të vendosë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
38. Kriteri i parë dhe kryesor i pranueshmërisë, të cilin Gjykata e shqyrton në lidhje me këtë dhe në të vërtetë me çdo kërkesë që i parashtrohet, është që të konstatohet se a e ka parashtruar parashtruesi kërkesën në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës që përcakton:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”
39. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës e ka parashtruar kërkesën në Gjykatë në emër të Këshillit Organizativ “Drejtësi për rastin Kiqina” në lidhje me dënimet e Burim Ramadanit, Arsim Ramadanit, Arben Kiqinës dhe Jeton Kiqinës, megjithatë nuk ka dorëzuar dokumentacion nga personat në fjalë me të cilin do të duhej që parashtruesja e kërkesës të autorizohet qartazi për t’i përfaqësuar ata në Gjykatë.
40. Gjykata vëren që, në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës nuk ka *locus standi* pranë Gjykatës, pasi që parashtruesja e kërkesës nuk i ka plotësuar kushtet procedurale të nenit 113.1 të Kushtetutës, në kuptimin që kërkesa nuk është ngritur në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
41. Sa i përket peticionit të nënshkruar nga afërsisht pesëdhjetë mijë (50.000) qytetarë të Republikës së Kosovës që është parashtruar në Gjykatë nga ana e parashtrueses së

kërkesës, për të mbështetur kërkesën, Gjykata vëren se nuk ka juridiksion të merret me kërkesa që janë *actio popularis*, që do të thotë aktet normative dhe vendimet nuk mund të kontestohen në abstrakt dhe se palët në këtë Gjykatë duhet të demonstrojnë që ato preken drejtpërdrejt nga akti normativ dhe/ose vendimi i kontestuar dhe në të vërtetë duhet të jenë palë e autorizuar pranë kësaj Gjykate në pajtim me nenin 113 të Kushtetutës që e rregullon juridiksionin e Gjykatës dhe ofron bazën juridike për parashtrimin e kërkesave nga ana e parashtruesve të kërkesë në këtë Gjykatë.

42. Kjo Gjykatë në rastin e kërkesës Rasti nr. KI51/10, Zivic Ljubisa, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Kryetarit të Republikës së Kosovës për emërimin e z. Zdravkovic Goran anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përfaqësim të komunitetit serb, i datës 2 mars 2012, theksoi si në vijim:

“Personi i cili nuk është prekur në këtë mënyrë, nuk e ka statusin e viktimës pasi që Kushtetuta nuk parasheh actio popularis. Me fjalë të tjera, një parashtrues i kërkesës nuk mund të ankohet në abstrakt ndaj masave të autoriteteve publike të cilat nuk janë zbatuar personalisht ndaj tij, siç është ky rast në këtë Gjykatë.”

43. Sikurse në atë rast, parashtruesja e kërkesës në këtë rast nuk preket nga dënimet e shpallura nga gjykatat e Kosovës dhe rrjedhimisht nuk është palë e autorizuar dhe kërkesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, pas shqyrtimeve më 15 maj 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'i komunikohet palës; dhe
- III. Ky Vendim do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Dr. Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani